




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORRUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY



Dep. DPK
Nr. i faq. 03
Broj stranica
Nr. pages

Nr. Prot. 03-03/1845/18
Data 09-07-2018
Prishtine

DATË/A:	06.07.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1833/18
PËR/ZA/TO:	z. Avni GASHI Menaxher i zyrës së Prokurimit-Kompania Ujësjetllësit Rajonal "PRISHTINA" Sh.A
CC:	Z Ilir Abdullahu Kryeshef Ekzekutiv-Kompania e Ujësjetllësit Rajonal "Prishtina" Sh.A
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: "Furnizim me klima te reja dhe Mirëmbajtja e kilmave ekzistuese" me nr. të prokurimit 70433736/18/4660/121, nr. të brendshëm KRUP 18/047/121.

I nderuar z. Gashi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.01/2014 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **"Furnizim me klima te reja dhe Mirëmbajtja e kilmave ekzistuese"** me nr. të prokurimit 70433736/18/4660/121, nr. të brendshëm KRUP 18/047/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **"Furnizim me klima te reja dhe Mirëmbajtja e klimave ekzistuese"** me nr. të prokurimit 70433736/18/4660/121, nr. të brendshëm KRUP 18/047/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 06 korrik 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: AKK-03-03-1833/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me klima te reja dhe Mirëmbajtja e klimave ekzistuese"** me nr. të prokurimit 70433736/18/4660/121, nr. të brendshëm KRUP 18/047/121, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Kompania Ujësjetllësi Rajonal "PRISHTINA" Sh.A.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë me kohëzgjatje 12 muaj, llojit furnizim, me vlerë të mesme të parashikuar 15,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur se autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ndërsa si nën kritere i ka caktuar: **1.** Furnizimi, montimi dhe lëshimi ne punë i klimave 60000 BTU, koeficientin prej 0.40%, nën kriteri **2.** Servisimi i Klimave ekzistuese me koeficientin prej 0.30%, nën kriterin **3.** Afati i Garancionit për Furnizimin dhe Montimin e klimave 60000 BTU me koeficient 0.20%, dhe nën kriterin **4.** Afati i Garancionit për servisimin e klimave ekzistuese me koeficient 0.10% .

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit për dhënie të kontratës nën kriterin nr. **3.** *"Afati i Garancionit për Furnizimin dhe Montimin e klimave 60000 BTU"* me koeficient 0.20%, dhe nën kriterin **4.** *"Afati i Garancionit për servisimin e klimave ekzistuese"* me koeficient 0.10%, nuk ka respektuar Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik, për faktin se në nenin 28 paragrafi 3 Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik i cili ka hyrë ne fuqi me dt.16.04.2018, specifikohen qartë cilat kritere mund të caktohet te kriteri i dhënies Tenderi ekonomikisht ma i favorshëm. Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues afatin e garancionit për furnizim montimin e klimave 60000 BTU dhe servisimin e klimave ekzistuese, mundë t'i specifikojë në Kushtet e kontratës ashtu siç parashihet me legjislacionin ne fuqi për prokurim publik..

Agjenci kundër Korrupsion, rekomandon autoriteti kontraktues që në rast se specifikon në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriterin për dhënie të kontratës tenderin ekonomikisht më të favorshëm, duhet të këtë kujdes që të caktoj nën kritere të qarta, precize, të matshme, të cilat janë në harmoni me legjislacioni në fuqi për prokurimi publik .

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27, nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 28 paragrafi 3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar të gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !